
	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 1 prej 44
		Versioni	1.0


Plani Investiv një (1) vjeçar i OSSh-së 2026

Maj 2026

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 2 prej 44
		Versioni	1.0

PËRMBAJTJA

1.HYRJE	3
2. PROJEKTET NË TENSION TË MESËM	5
2.1 Projektet për shtimin e kapacitetit transformues dhe rivitalizimin e nënstacioneve 35/10(20)[kV]	5
2.2 Projektet e kalimit në nivelin e tensionit 20 [kV].....	5
2.2.1 Projektet e planifikuara për vitin 2026.....	6
2.3 Projektet në nivelin 10 [kV]	8
2.3.1 Projektet e planifikuara për vitin 2026.....	8
2.3.2 Projektet e planifikuara për vitin 2026 – Veriu i Kosovës.....	15
2.4 Projektet në proces të implementimit	17
2.4.1 Projektet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe statusi i tyre	17
2.4.2 Konvertimi i daljeve në nivelin e tensionit 20 [kV] gjatë vitit 2025.....	20
2.4.3 Daljet në proces të implementimit për konvertim në 20 [kV] gjatë vitit 2026	22
2.4.4 Projektet e planifikuara dhe të aprovuara në vitin 2025, implementimi i të cilave do të vazhdoj edhe në vitin 2026.....	22
3.PROJEKTET NË TENSION TË ULËT	24
3.1 Projektet për zgjerim dhe përforcim të rrjetit 0.4 [kV]	24
3.2 Projektet e planifikuara për vitin 2026 – Veriu i Kosovës.....	28
4.PROJEKTET NË RRJET TË MENÇUR	28
5.PROJEKTET NË NJEHSORË	41
6.PROJEKTET NË LOGJISTIKË	41
7.PROJEKTET E TEKNOLOGJISE INFORMATIVE(IT)	42
8.PËRFUNDIM	44

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 3 prej 44
		Versioni	1.0

1.HYRJE

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes investon vazhdimisht në rrjetin e shpërndarjes bazuar në buxhetin e alokuar të investimeve të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Investimet e OSSh-së në rrjetin e shpërndarjes rrisin funksionimin e sistemit shpërndarës në mënyrë që të arrihet një furnizim i besueshëm me energji elektrike, të rritet kapaciteti i rrjetit ekzistues dhe përdorimi ekonomik i rrjetit të shpërndarjes. Rritja e shpejtë e kërkesës për energji po mbingarkon vazhdimisht linjat ekzistuese si rezultat i zhvillimeve të reja, duke shkuar kështu në kufi të kapacitetit maksimal të linjës. Prandaj, OSSh duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmbushur detyrimin për të siguruar të gjithë përdoruesve të sistemit energji cilësore dhe mundësinë e kyçjes në përputhje me ligjin e energjisë elektrike dhe kodin e rrjetit të shpërndarjes. Për më tepër, nga investimet e reja OSSh optimizon dhe balancon ngarkesat e daljeve.

Prioritizimi i projekteve të investimeve në rrjet bëhet duke analizuar kriteret teknike si:


- Humbjet
- Ngarkesën e rrjetit
- Rëniat e tensionit
- Indekset e ndërprerjeve
- Kërkesën totale në terma të energjisë
- Rritjen e konsumit
- Numrin e konsumatorëve

Pothuajse të gjitha daljet shpërndarëse kryesisht kanë topologji të ngjashme. Rrjeti në zonat radiale përbëhet nga linja të gjata dhe me shumë degëzime, ndërsa rrjeti në zonat urbane përbëhet nga një strukturë unazore e papërcaktuar që ka vështirësi për operim. Metodologjia e re e planifikimit nuk mbështet topologjinë ekzistuese të daljeve, prandaj daljet shpërndarëse janë të organizuara drejt një topologjie të re, standarde dhe sa më të thjeshtë për operim.

Me topologjinë e re arrihen synimet e planifikimit drejt:

- Rrjetit të zgjerueshëm, standard dhe të thjeshtë
- Përmirësimit të cilësisë së furnizimit për të gjithë konsumatorët
- Strukturës së rrjetit të besueshëm në zonat urbane
- Reduktimit të humbjeve të energjisë
- Aftësisë së izolimit të defektit në rrjetin rural duke përdorur nënstacionet shpërndarëse në kryqëzimet e daljeve.

Njehsorët - përfshijnë projektet që janë si rezultat i kërkesave ligjore, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të shpërndarjes dhe të cilat do të ketë ndikim në të gjithë konsumatorët.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 4 prej 44
		Versioni	1.0

Projektet e rrjetit të mençur - Fokusi i aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm në mbarë botën, si dhe te ne është automatizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, duke përdorur avancimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë dhe sistemit të komunikimit të të dhënave. Në kuadër të kësaj pjese hyjnë projektet SCADA, DMS, GIS etj.

Logjistika - janë domosdoshmëri që sigurojnë vazhdimësinë e biznesit, dhe të cilat me kalimin e kohës duhet të ndërrohen për shkak të kostos së tyre të lartë të mirëmbajtjes dhe / ose dëmeve të riparuarua.

Shërbimet mbështetëse - të cilat përfaqësojnë shërbime, të tilla si IT (Teknologji Informativ), e të cilat janë edhe të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e biznesit por njëherazi janë edhe projektet sipas kërkesave ligjore.

Projektet e rrjetit të shpërndarjes do të kategorizohen si më poshtë:


Tensioni i mesëm (projektet në nivelin 35 [kV], projektet në nivelin 10 [kV], projektet për kalimin në nivelin 20 [kV]), tensioni i ulët (projektet për përforcim dhe zgjerim të rrjetit), rrjeti i mençur, njehsorët, IT, dhe logjistika.

Kostoja për këto projekte për vitin 2026 është dhënë në tabelën më poshtë.

Tabela 1. Kostoja e aprovuar e projekteve për vitin 2026

Projektet	Kostoja [Euro]
Tensioni i Mesëm	11,371,792
Tensioni i Ulët	4,798,998
Rrjeti i Mençur	4,168,571
Njehsorët	9,164,270
IT	3,349,959
Logjistika	2,365,000
TOTAL	35,218,590

Më poshtë janë paraqitur shpjegimet e detajuara për secilën kategori të projekteve investive.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 5 prej 44
		Versioni	1.0

2. PROJEKTET NË TENSION TË MESËM

Projektet investive në tension të mesëm ndahen në:

1. Projektet në nivelin 35 [kV],
2. Projektet e kalimit në nivelin 20 [kV] dhe
3. Projektet në nivelin 10 [kV]

2.1 Projektet për shtimin e kapacitetit transformues dhe rivitalizimin e nënstacioneve 35/10(20)[kV]

Projektet e planifikuara për vitin 2026

Rivitalizimi i nënstacioneve ekzistuese dhe instalimi i kthinave të reja të transformatorëve brenda tyre përbën një ndër veprimet kyçe në drejtim të modernizimit të infrastrukturës energjetike në rrjetin shpërndarës. Këto ndërhyrje janë thelbësore për të rritur kapacitetin transformues dhe për të përmirësuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë operacionale të sistemit. Për këtë arsye, nënstacionet ku planifikohen të instalohen kthina me qëllim të konvertimit të daljeve 10 [kV] në nivelin 20 [kV] janë:

- NS Istogu 110/10 [kV]
- NS Gurakovci 35/10 [kV]

Këto kthina në këto dy nënstacione do të shërbejnë për të njëjtin qëllim të konvertimit nga niveli 10 në atë 20 [kV]. Numri i kthinave që do të instalohen sipas nivelit të tensionit është paraqitur më poshtë:


Tabela 2. Numri i kthinave të instaluar.

Projekti - Ndërrimi i kthinave	Nr. i kthinave	35 [kV]	24 [kV]
Istogu 110/10 [kV]	3	0	3
Gurakovci 35/10 [kV]	3	0	3
Lipjani 110/35/10 [kV]	32	0	32

2.2 Projektet e kalimit në nivelin e tensionit 20 [kV]

Prej të gjitha metodave për zvogëlimin e humbjeve teknike, metoda e kalimit prej një niveli të tensionit në një nivel më të lartë është mënyra më e mirë për përmirësimin e kualitetit të tensionit, gjegjësisht i zvogëlon humbjet teknike jashtëzakonisht shumë dhe përmirëson tensionin deri në pikën e fundit të konsumatorit nëpër daljet 20 [kV]. Për të realizuar investimet 20 [kV] në daljet 10 [kV], OSSh do të përdorë tri burime furnizimi:

- Do të investojë në daljet 10 [kV] në transformatorët e OST-së që e kanë mundësinë e kalimit në 20 [kV] ose do të kërkohet nga OST të përshtaten transformatorët,

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 6 prej 44
		Versioni	1.0

- Do të shfrytëzohen transformatorët 8 [MVA] për t'i adaptuar në 35/20 [kV] për t'i furnizuar daljet e zgjedhura,
- Do të përdoren transformatorë ngritës 10/20 [kV] për të furnizuar dalje të zgjedhura për investim.

2.2.1 Projektet e planifikuara për vitin 2026

Projektet e kalimit në nivelin 20 [kV] për vitin 2026 janë:

- 03/26-05 [20kV] - Peqani
- 03/26-06 [10kV&20kV] - Bodrumi & Dalja e re Hasi

• Projekti: Bodrumi & Dalja e re Hasi I, 03/26-03 10 [kV]kV & 20 [kV]

Dalja 10 [kV] Bodrumi furnizohet nga NS 110/35/10 [kV] Prizereni 1. Karakterizohet me shumë degëzime, numër të madh të TS-ve, ngarkesë maksimale të madhe, humbje të larta teknike, rënie të tensionit nën standarde të kërkuara dhe numër të lartë të ndërprerjeve të pa planifikuara. Një pjesë e trungut të daljes dhe degëzimeve janë të ndërtuara me shtylla druri.

Me qëllim të përmirësimit të parametrave të linjës, është propozuar ndarja e daljes në dy pjesë, dalja Bodrumi dhe dalja e re Hasi I. Dalja e re Hasi I do të operojë në nivelin 20 [kV] dhe do të furnizohet nga NS 35/10(20) [kV] Pirana.





Figura 1. Topologjia e propozuar e daljes Hasi I 20[kV].

Tabela 3. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërke sa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Bodrumi	5.43	192.12	1,314.92	0.73	149	2334
	Rahoveci	5.41	156.96	1,309.60	0.75	110	1735

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 7 prej 44
		Versioni	1.0

Pas	Bodrumi 10kV	3.27	64.47	397.77	0.897		999
	Hasi I 20kV*	3.83	49.8	256.43	0.974		2151
	Rahoveci**	3.68	105.95	731.82	0.847		973

*Pasi transferohen 23 TS-e nga dalja Bodrumi te dalja Hasi I

**Pasi transferohen 3 TS-e nga dalja Rahoveci te dalja Hasi I dhe 6 TS-e nga dalja Rahoveci te dalja Bodrumi.

- **Projekt: Peqani, 03/26-05 [20kV]**

Peqani karakterizohet nga një numër i madh prishjesh, kohëzgjatje mesatare e lartë e ndërprerjeve, rënie të tensionit të lartë, humbje të larta teknike dhe Pmax të madh. Në fund të linjës, dy degëzime të linjës kalojnë në një terren malor të papërshtatshëm që ndikon në kohën e gjetjes dhe shmangies së ndërprerjeve dhe e vështirëson mirëmbajtjen.





Figura 2. Topologjia e propozuar e daljes Peqani

Tabela 4. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Peqani - 10 kV	6.62	123.06	1,176.06	0.82	61	3033
Pas	Peqani - 20 kV*	6.82	63.66	428.45	0.96	-	3,098

* 2 transfostacione transferohen nga dalja Budakova tek dalja Peqani - kalkulimet teknike të këtyre daljeve pas investimeve i gjeni tek projekti Peqani në këtë dokument.

Në këtë dalje do të investohet tërësisht dhe do të konvertohet në nivelin 20 [kV] për t'u mundësuar konsumatorëve furnizim të sigurtë dhe kualitativ me energji elektrike.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 8 prej 44
		Versioni	1.0

2.3 Projektet në nivelin 10 [kV]

Projektet e planifikuara për investim në nivelin 10 [kV] janë dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të pandërprerë me energji për konsumatorët, për të siguruar funksionimin e rrjetit në përputhje me rregullat, kodet dhe ligjet në fuqi. Objektivat kryesore të këtyre projekteve i adresohen çështjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:


- Rritja e sigurisë, efikasitetit, besueshmërisë dhe cilësisë teknike të rrjetit të shpërndarjes
- Rritja e cilësisë së furnizimit me energji elektrike (treguesit e vazhdimësisë së furnizimit, cilësisë së tensionit, etj.)
- Përshtatja e kapaciteteve bartëse dhe transformuese në raport me rritjen e ngarkesës dhe konsumit të energjisë
- Zvogëlimi i humbjeve teknike
- Rehabilitimi dhe modernizimi i stabilimenteve dhe rrjetit ekzistues
- Pajtueshmëria me standardet e operimeve dhe performancës

2.3.1 Projektet e planifikuara për vitin 2026

Projektet në nivelin 10 [kV] për vitin 2026 janë:

- 03/26-04 [10kV] - Rruga e Reqanit
- 03/26-06 [10kV&20kV] - Bodrumi & Dalja e re Hasi
- 06/26-07 [10kV] - Bresalci
- 07/26-03 [10kV] - Shipoli, Ibër Lepenci & Dalja e re
- 05/26-10 [10kV] – Gremniku
- **Projekti: Rruga e Reqanit, 03/26-04 [10kV]**

Dalja 10 [kV] Rruga e Reqanit, e cila aktualisht ka segmente me shtylla druri dhe përçues me seksion të pamjaftueshëm prej 25 [mm²], duke ndikuar në sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike. Investimi parashikon zëvendësimin e përçuesve dhe shtyllave sipas gjendjes teknike, si dhe kalimin nga rrjeti ajror në rrjet nëntokësor në segmente të caktuara. Po ashtu, parashihet rikonfigurimi i rrjetit, ku dy trafostacione do të furnizohen nga dalja 10 [kV] Theranda 2. Implementimi i projektit do të rrisë besueshmërinë, sigurinë operative dhe cilësinë e furnizimit, si dhe do të mundësojë lidhje unazore me daljet e tjera të qytetit. Në vazhdim është paraqitur gjendja e propozuar e daljes. Linjat me ngjyrë të zezë duhet të demolohen.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 9 prej 44
		Versioni	1.0




Figura 3. Topologjia e propozuar e daljes së re - Rruga e Reqanit 2.

Tabela 5. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Nr.i konsumatorëve
Para	J05 Rruga e Reqanit	3.21	124.49	632.97	0.91	1678
Pas	J05 Rruga e Reqanit	3.08	81.73	473.60	0.95	1553

- **Projekti: Bodrumi & Dalja e re Hasi I, 03/26-03 10 [kV]kV& 20 [kV]**

Pas planifikimit të ndarjes së daljes Bodrumi dhe krijimit të daljes së re Hasi I, e cila operon në nivelin 20 [kV] dhe furnizohet nga NS 35/10(20) [kV] Pirana, dalja ekzistuese Bodrumi vazhdon operimin në nivelin 10 [kV]. Në vijim paraqitet topologjia e përditësuar e daljes Bodrumi, si dhe kalkulimet teknike përkatëse.




Figura 4. Topologjia e propozuar e daljes Bodrumi 10 [kV]


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 10 prej 44
		Versioni	1.0

Tabela 6. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Bodrumi	5.43	192.12	1,314.92	0.73	149	2334
	Rahoveci	5.41	156.96	1,309.60	0.75	110	1735
Pas	Bodrumi 10kV	3.27	64.47	397.77	0.897		999
	Rahoveci**	3.68	105.95	731.82	0.847		973

*Pasi transferohen 23 TS-e nga dalja Bodrumi te dalja Hasi I


**Pasi transferohen 3 TS-e nga dalja Rahoveci te dalja Hasi I dhe 6 TS-e nga dalja Rahoveci te dalja Bodrumi.

- **Projekti: Bresalci, 06/26-07 [10kV]**

Aktualisht, dalja Bresalci përballet me mbingarkesë të theksuar, humbje teknike të konsiderueshme, si dhe rënie të mëdha të tensionit, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë, sigurinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e kësaj zone. Në figurën e mëposhtme paraqitet topologjia e re e propozuar, e cila synon optimizimin e rrjetit shpërndarës, uljen e humbjeve teknike, dhe rritjen e sigurisë në furnizim. Ndërtimi i linjave të reja nëntokësore përgjatë rrugëve të Ministrisë, duke shfrytëzuar kanalet ekzistuese në disa segmente (në fillim dhe përgjatë autostradës), si dhe ndërtimi i kanaleve të reja në zonat ku mungon infrastruktura ekzistuese. Ndërtimi i linjave të reja ajrore, në segmente ku është e mundur është përdorur trasa ekzistuese me ndërrim të përcuesit, ndërsa në zona të pamundshme për shfrytëzim (për shkak të relievit malor), është ndërtuar trase e re. Ndërtimi i një stabilimenti të ri, i cili ndahet në disa degëzime për balancimin e ngarkesës dhe për përmirësimin e shpërndarjes së energjisë në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme.

Tabela 7. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Bresalci	4.24	148.86	1363.33	0.754	66	2714
Pas	Bresalci	3.45	63.41	317.94	0.982	-	2714

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 11 prej 44
		Versioni	1.0




Figura 5. Topologjia e propozuar e daljes – Bresalci

Tabela 8. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Kufca - 10 kV	1.74	61.87	250.21	0.90	38	1337
Pas	*Kufca - 10 kV	2.57	63.32	316.08	0.861	-	1337

*Pasi të transferohen 5 transfostacione nga dalja J10 Bresalcit te dalja J06 Kufca.

*Pasi të transferohet 1 trafostacion nga dalja Rrethi te dalja J06 Kufca.

- Projekti: Shipoli, Ibër Lepenci & Dalja e re, 07/26-03 [10kV]**

Topologjia ekzistuese e daljeve Shipoli dhe Iber Lepenci përfshin degë me distanca të gjata, që do të thotë që të dy daljet kanë rënie të tensionit jashtë standardeve të kërkuara dhe linja të mbingarkuara. Gjithashtu, një pjesë e madhe e rrjetit ekzistues të daljes Shipoli është e ndërtuar me shtylla të vjetra prej druri në zonën rurale.

Për të ulur ngarkesën dhe përmirësuar kualitetin e tensionit, topologjia e re përfshin krijimin e një dalje të re. Në vazhdim janë paraqitur gjendjet e propozuara te daljeve Shipoli, Ibër Lepenci dhe Dalja e re.


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 12 prej 44
		Versioni	1.0



Figura 6. Topologjia e propozuar e daljes Iber Lepenci




Figura 7. Topologjia e propozuar e daljes Shipoli 10 [kV]




Figura 8. Topologjia e propozuar e daljes Dalja e re Shipoli 10 [kV]


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 13 prej 44
		Versioni	1.0

Tabela 9. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Shipoli	5.252	103.93	806.32	0.937	44	2334
	Ibër Lepenci	5.18	160.31	859.83	0.911	36	2051
Pas	Shipoli	2.31	52.59	368.17	0.962	-	766
	Ibër Lepenci	4.745	66.60	255.33	1.026	-	1894
	Dalja e re (Shipoli & Ibër Lepenci)	3.62	50.87	215.84	1.025	-	1725

Nga dalja Ibër Lepenci, një pjesë e ngarkesës kalon me daljen Dalja e re (Shipoli & Ibër Lepenci), pjesa e hijezuar me ngjyrë të verdhë në figurat e mësipërme.

- **Projekti: Gremniku, 05/26-10 [10kV]**

Dalja Gremniku në gjendjen ekzistuese përballet me probleme serioze si rëniet e shpeshta të tensionit, ndërprerjet e furnizimit dhe humbje të larta teknike. Këto vështirësi janë kryesisht pasojë e gjendjes së dobët të rrjetit ajror, i cili është i ndërtuar me shtylla druri. Fillimisht ishte propozuar që kjo dalje të investohet pjesërisht, pastaj të konvertohej në tensionin 20 [kV], mirëpo pas një rishikimi më të detajuar është vendosur që dalja Gremniku të ndahet në dy dalje të veçanta, me qëllim të ndarjes së ngarkesës dhe përmirësimit të performancës së rrjetit. Krijimi i daljes së re do të ndihmojë gjithashtu në të ardhmen edhe për shkarkimin e daljes ekzistuese Dresniku, duke marrë përsipër furnizimin e disa trafostacioneve që aktualisht mbingarkojnë atë dalje. Ky propozim na siguron një kapacitet të mjaftueshëm dhe të balancuar në të dy daljet, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, reduktimin e humbjeve teknike, dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit shpërndarës në zonë.


Tabela 10. Të dhënat teknike para dhe pas investimeve

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Nr.i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Gremniku 10kV	4.82	134.80	1,251.71	0.747	53	1871
Pas	Gremniku 10kV	2.68	73.80	476.21	0.903	-	1278

Tabela 11. Të dhënat teknike para dhe pas transferimeve

Dalja TM		Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Numri i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Para	Voljaka ekz	0.77	26.40	132.70	0.96	-	130
Pas	Voljaka e re	0.89*	30.70	61.13	0.95	-	319

*Pas transferimeve të 6TS nga dalja Gremniku tek Volljaka.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 14 prej 44
		Versioni	1.0

*Pas transferimeve të 5TS nga dalja Volljaka te Gremnku




Figura 9. Topologjia propozuese e daljes Gremniku.





Figura 10. Topologjia propozuese për daljen e re

Tabela 12. Të dhënat teknike për daljen e re

	Dalja TM	Kërkesa [MW]	Ngarkesa Max. e Linjës [%]	Humbjet [MWh]	Tensioni Min. [p.u]	Nr.i ndërprerjeve	Nr.i konsumatorëve
Pas	Dalja e Re	1.90	52.7	242.94	0.958	-	592

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 15 prej 44
		Versioni	1.0

2.3.2 Projektet e planifikuara për vitin 2026 – Veriu i Kosovës

Tabela 13. Lista e Projektve në Mitrovicën e Veriut


Projektet në Mitrovicën e Veriut	Materiali	Sasia	Njësia
Dalja 10 [kV] Zhitkovci (Žitkovac)	Ndarës linjor me rikyçje automatike	1	copë
Rikonstruksioni i stabilimenteve 10 [kV] në NS 35/10 [kV] Leshak (Lešak) dhe ndërtimi i TS-it 10/0.4[kV]	Kthina dalëse tip “Metal-Clad” me ndërprerës	1	copë
	TS 10/0.4 [kV], 400 [kVA]	1	copë
Ndërtimi i linjës 10 [kV] nga NS 35/10 [kV] Leposaviq (Leposavić) deri te TS 10/0,4 [kV] Kutnje	Linjë nëntokësore	0.6	km
	Linjë ajrore	0.5	km
Ndërtimi i linjës 10 [kV] nga NS 35/10 [kV] Uglare (Ugljare) deri te TS 10/0,4 [kV] Palestra Sportive (Sportska Hala)	Linjë nëntokësore	0.32	km
	Linjë ajrore	2	km
	Kthina të mbyllura	2	pcs
Instalimi i ndarësve linjor me rikyçje automatike	Ndarës linjor me rikyçje automatike	2	copë
Ndërtimi i linjës 10 [kV] Zveçani i Vogël – Zvečan (Mali Zvečan – Zvečan) dhe linjës 10 [kV] nga TS 10/0.4 [kV] Tjegullorja (Crepociglana) deri te 10/0.4 [kV] Gateri	Linjë ajrore	2.6	km
	Transformatorë	26	copë
Rritja e kapacitetit të NS 35/10 [kV] Gazivode	Fushë transformatorike	1	copë

- Projekti: Dalja 10 [kV] Zhitkovci (Žitkovac)**

Dalja 10 [kV] Zhitkovci është linjë shumë e gjatë mbi 50 [km], furnizon konsumator kryesisht në teren malor dhe furnizon 16 TS. Vjetërsia e linjës, konfiguracioni kodrinor - malor i terrenit ku kalon linja, rrugët e këqija dhe vegjetacioni përreth linjës, bëjnë që gjetja dhe eliminimi i prishjeve është shumë i vështirë. Gjithashtu, mungesa e ndarësve të linjës ndikon që në rastet e prishjeve, dalja të mbetet jashtë pune një kohë të gjatë. Instalimi i ndarësit linjor me rikyçje automatike në degëzim të daljes, do ta bënte shumë më të lehtë dhe më të shpejtë gjetjen e prishjes.

- Projekti: Rikonstruksioni i stabilimenteve 10 [kV] në NS 35/10 [kV] Leshak (Lešak) dhe ndërtimi i TS-it 10/0.4 [kV]**

Aktualisht nga TS-i për vetëkonsum të NS 35/10 [kV] Leshak furnizohen konsumatorët e katër ndërtesave dhe rreth pesëmbëdhjetë shtëpive. Duke instaluar në NS 35/10 [kV] Leshak një kthinë të re 24 [kV] tip “Metal-Clad” me ndërprerës, si dhe duke ndërtuar një TS të ri 10/0.4 [kV] me fuqi 400 [kVA] tip shtyllë metalike, do të mundësohej transferimi i këtyre konsumatorëve nga TS-i për vetëkonsum në daljen 10 [kV]

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 16 prej 44
		Versioni	1.0

Leshak-Qytet. Me anë të këtij investimi do ti kthehej roli i TS-it për vetëkonsum për të cilin është i destinuar. Ky investimi do të ndikoj në rritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe në furnizimin cilësor të konsumatorëve që furnizohen nga NS 35/10 [kV] Leshak dhe TS-i i ri.

- **Projekti: Ndërtimi i linjës 10 [kV] nga NS 35/10 [kV] Leposaviq (Leposavić) deri te TS 10/0,4 [kV] Kutnje**

Dalja 10 [kV] "Lagjja e Trepçës" është dalje e gjatë që furnizon konsumator në zonat urbane dhe rurale (7 TS janë në zonë urbane dhe 20 TS janë në zonë rurale). Duke ndërtuar linjën e re nga NS 35/10 [kV] Leposaviq deri te TS 10/0,4 [kV] Kutnje, do të mundësohej transferimi i 7 TS-ve që e furnizojnë qytetin në daljen e re. Kjo do të mundësoj shkarkimin e daljes 10 [kV] "Lagjja e Trepçinës", furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor të konsumatorëve dhe rritjen e kapacitetet bartës të linjave, duke krijuar bazën për lidhjen e konsumatorëve të rinj në rrjetin 10 [kV].

- **Projekti: Ndërtimi i linjës 10 [kV] nga NS 35/10 [kV] Uglare (Ugljare) deri te TS 10/0,4 [kV] Palestra Sportive (Sportska Hala)**

Ndërtimi i kësaj pjese të linjës pranë lumit Ibër është i nevojshëm për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor të asaj pjese të Zubin Potokut. Aktualisht, ajo pjesë furnizohet nga dy drejtime: nga dalja 10 [kV] Zubin Potok që furnizohet nga NS 35/10 [kV] Gazivoda dhe nga dalja 10 [kV] Zubin Potok që furnizohet nga NS 35/10 [kV] Ugljare. të dyja këto drejtime janë nën ngarkesë të madhe.


Dalja e re, do të furnizonte me energji elektrike edhe TS 10/0.4 [kV] Palestra e Sporteve me fuqi 1000 [kVA] dhe TS 10/0.4 [kV] Bazen, me fuqi prej 630 [kVA].

- **Projekti: Instalimi i ndarësve linjor me rikyçje automatike**

Dalja 10 [kV] "Luçka reka" (furnizon 31 TS distributiv) dhe dalja 10 [kV] "Bërnjak" (furnizon 23 TS), janë linja shumë të gjatë mbi 50 [km] secila, që furnizojnë kryesisht konsumatorë në zonat me terren malor. Moshë e linjave, konfigurimi i terrenit kodrinor-malor, rrugë të vështira për qasje në linja si dhe vegjetacioni përgjatë linjës shpesh ndikojnë në prishje të shpeshta të daljeve duke e vështirësuar gjetjen dhe evitimin e prishjeve. Duke instaluar ndarës linjor me rikyçje automatike në daljen 10 [kV] "Luçka reka" në degën në drejtim të Vitkoviqi (Vitkovići) dhe në daljen 10 [kV] "Bërnjak" në degën në drejtim te TS 10/0.4 [kV] Preseka, do të bëhej e mundur gjetja me e lehtë e defekteve dhe furnizim më të mirë të pjesës së rrjetit që nuk është në prishje.

- **Projekti: Ndërtimi i linjës 10 [kV] Zveçani i Vogël – Zveçan (Mali Zvečan – Zvečan) dhe linjës 10 [kV] nga TS 10/0.4 [kV] Tjegullorja (Crepociglana) deri te 10/0.4 [kV] Gateri**

Ndërtimi i këtyre linjave është i nevojshëm për të eliminuar furnizimin me energji nga NS 35/10 [kV] në pronësi të Trepçës. Linjat aktuale janë 6.3 [kV] dhe 3.3 [kV]. Kjo ndikon në furnizimin jo cilësor të konsumatorëve me energji elektrike. Këto linja furnizojnë TS që janë të vjetër dhe me një nivel të lartë humbesh teknike. Aktualisht, furnizimi me energji i TS-ve është i njëanshëm, dhe instalimi i një linjë të dyfishtë do të siguronte një furnizim të dyanshëm me energji elektrike, do të zvogëlonte ndërprerjet në rast të ndonjë defekti, do të rriste kapacitetin bartës dhe do të përmirësonte furnizimin me energji në Zveçan,

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 17 prej 44
		Versioni	1.0

pra duke ndryshuar burimin e furnizimit me energji elektrike nga NS Trepça, që është në pronësi private dhe është më shumë se 50 vjet dhe i paqëndrueshëm, në NS Zveçani i Vogël i cili është me i ri.

- **Projekti: Rritja e kapacitetit të NS 35/10 [kV] Gazivode**

NS 35/10 [kV] Gazivode ka një transformator rezervë 35/10 [kV] me fuqi të instaluar 2.5 [MVA] i cili tani është jo aktiv. Vënia në funksion e këtij transformatori, do të siguronte rritje të kapacitetit ekzistues të NS Gazivode për 2.5 [MVA]. Rritja e kapacitetit siguron stabilitet në furnizim dhe do të plotësonte nevojat e konsumatorëve të Zubin Potokut për një periudhë të caktuar në të ardhmen.


2.4 Projektet në proces të implementimit

2.4.1 Projektet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe statusi i tyre


Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur projektet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe statusi i tyre:

Tabela 14. Lista e projekteve të realizuara.


Distrikti	Emri i Projektit	Niveli i Tensionit	Statusi i projekteve	Komente
DFE	Varoshi	10 [kV]	I përfunduar	
DFE	Gaçka	10 [kV]	I përfunduar	
DFE	Bobi	10 [kV]	I përfunduar	
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 1	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 2	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 3	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 4	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 5	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 6	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 7	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DFE	Qendra e Ferizajt - Dalja 8	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Feeder 1 - Skivjani, Dobroshti, Beci	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Ponosheci Feeder (Dobroshti side)	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Ponosheci Feeder	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Bistazhini Feeder	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 18 prej 44
		Versioni	1.0

DGJ	Mirusha Feeder	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Kijeva Feeder	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Bellanica Feeder	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Malisheva	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Dragobili	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DGJ	Banja	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPZ	Mushtishti	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DMI	Qytet e Fshatra Feeder	10 [kV]	I përfunduar	
DMI	Nadakofc	10 [kV]	I përfunduar	
DPE	Ledinat	10 [kV]	I përfunduar	
DPR	Bardhi Madh	10 [kV]	I përfunduar	
DPR	Prishtina 7 - Feeder 1	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Prishtina 7 - Feeder 2	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Prishtina 7 - Feeder 3	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Prishtina 7 - Feeder 4	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Prishtina 7 - Feeder 5	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Prishtina 7 - Feeder 6	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Prishtina 7 - Feeder 7	20 [kV]	I përfunduar	Jane konvertuar ne nivelin 20 [kV]
DPR	Feeder 3 - Kroni i Bardhë	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20[kV]
DPR	Feeder 4 - Dardania	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	Feeder 6 - Ulpiana	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	Prishtina 5 - Feeder 2	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	Prishtina 5 - Feeder 5	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	Prishtina 5 - Dega e Butovcit	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P2-P3 Feeder 2	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P2-P5 Feeder 1	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P2-P5 Feeder 2	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P2-P5 Feeder 3	20 [kV]	I përfunduar	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 19 prej 44
		Versioni	1.0

DPR	Feeder 1 - Perparimi	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	Feeder 5 - Fakulteti Filozofik	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	PR 3 - Arberia - Feeder 1	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	PR 3 - Arberia - Feeder 2	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P5 - Feeder 1	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20[kV]
DPR	P5 - Feeder 3.2	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P5 - Feeder 3.1	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P5 - Feeder 4	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P3-P5 Feeder 1	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P3-P5 Feeder 2	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P2-P3 Feeder 1	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	P2-P3 Feeder 3	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DPR	Dalja e re nga NS Podujeva (Letanci & Fshatrat 1)	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DPR	Dalja e re nga NS Besi (Lluzhani & Fshatrat2)	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DFE	Kosovapetroli	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DGJ	Pataqani	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DGL	Ropotova	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DGL	Begunca	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DMI	Feeder 4 - Qirezi	20 [kV]	Në proces të implementimit	
DMI	Maxhunaj	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DMI	Brgjani	10 [kV]	Në proces të implementimit	Projekt ne Mitrovicen e Veriut

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 20 prej 44
		Versioni	1.0

DPE	Barani Feeder	20 [kV]	Në proces të implementimit	
DPE	Spitali i Pejes, Maja Zeze	10 [kV]	Në proces të implementimit	
DPZ	Dalja 10 [kV]kV Brodi	10 [kV]	Në proces të implementimit	Projekt ne bashkepunim me komunen e Dragashit
DPZ	Dalja 10 [kV] kV Restelica	10 [kV]	Në proces të implementimit	Projekt ne bashkepunim me komunen e Dragashit
DGJ	Feeder 2 - Cermjani, Beci, Ereniku	20 [kV]	Në proces të implementimit	Ne vitin 2026 do te konvertohet ne 20 [kV]
DGJ	Opterusha, Fortesa, Bodrumi	10 [kV]	Në proces të implementimit	

Distrikti Gjakovë: "Xërxa, 18 Nëntori", "Xërxa, Ura Terezive, Opterusha", "Opterusha, Fortesa, Bodrumi" - Komuna e Rahovecit është duke investuar në ndërtimin e rrugës Rahovec–Xërxë, dhe në këto projekte ishte planifikuar hapja e kanalit përgjatë kësaj rruge; për këtë arsye, aktualisht jemi në pritje që Komuna të përfundojë ndërtimin e rrugës. Ndërsa punimet e tjera të projektit, jashtë kësaj rruge, janë realizuar.

Distrikti Prizren: Hoqa e Qytetit – Ky projekt është i bllokuar për shkak se qytetarët nuk lejojnë instalimin e disa shtyllave, pjesa tjetër e projektit ka përfunduar.

2.4.2 Konvertimi i daljeve në nivelin e tensionit 20 [kV] gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, KEDS ka vazhduar me intensitet të shtuar aktivitetet për konvertimin e linjave ekzistuese nga 10 [kV] në 20 [kV], duke përfshirë rehabilitimin e infrastrukturës, zëvendësimin e pajisjeve dhe përshtatjen e nënstacioneve për operim në nivelin e ri të tensionit.




Figura 11. Konvertimi i daljeve nga 10 [kV] në 20 [kV]

Me konvertimin e daljeve 10 [kV] në 20 [kV] është përmirësuar kualiteti i tensionit tek të gjithë konsumatorët e këtyre daljeve, është dyfishuar kapaciteti bartës, është realizuar sistemi unazor nga dy burime të ndryshme duke minimizuar kohëzgjatjen e ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike.



	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 21 prej 44
		Versioni	1.0

Tabela 15. Lista e daljeve të cilat janë konvertuar në nivelin 20 [kV]

Nr.	Distrikti	Nënstacioni	Kodi i Daljes	Emri i Daljes	Tensioni
1	DPR	Prishtina 2 110/10(20) [kV]	11000080	QKUK	20 [kV]
2	DPR	Prishtina 2 110/10(20) [kV]	11000082	Sh.M 28 Nentori	20 [kV]
3	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000091	Pallati i Drejtesise	20 [kV]
4	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000096	Fabrika e kasetave	20 [kV]
5	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000095	Grand Store	20 [kV]
6	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000093	QKUK	20 [kV]
7	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000089	Viva Fresh	20 [kV]
8	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000094	Veterniku 1	20 [kV]
9	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000098	Hajvalia 1 - KT	20 [kV]
10	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000099	Hajvali Irfani	20 [kV]
11	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000092	M.Adm.Publike	20 [kV]
12	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000097	Ulzat	20 [kV]
13	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000088	Kodrina	20 [kV]
14	DPR	Prishtina 7 110/10(20) [kV]	19000090	Albi Mall	20 [kV]
15	DPZ	Theranda 110/10(20) [kV]	32000002	Mushtishti	20 [kV]
16	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	400410xx	Banka 1 & Dalja 1	20 [kV]
17	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	400410xx	Banka 2 & Dalja 2	20 [kV]
18	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	400410xx	Banka 3 & Dalja 3	20 [kV]
19	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	40041001	Sillosi	20 [kV]
20	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	40000031	V.Gervalla	20 [kV]
21	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	400000xx	Driton Islami	20 [kV]
22	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	40041038	Kosova Transi 1	20 [kV]
23	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	40041034	Rexhep Bislimi 2	20 [kV]
24	DFE	Ferizaj II 35/10(20) [kV]	40041037	Kosova Transi 2 Dalja 4	20 [kV]
25	DFE	Ferizaj III 35/10(20) [kV]	40042037	Gjon Serreqi	20 [kV]
26	DFE	Ferizaj III 35/10(20) [kV]	40042015	Ylli 1	20 [kV]
27	DFE	Ferizaj III 35/10(20) [kV]	40042016	Ylli 2	20 [kV]
28	DFE	Ferizaj III 35/10(20) [kV]	40042017	Ylli 3	20 [kV]
29	DFE	Ferizaj III 35/10(20) [kV]	40042018	Dalja Nr.18	20 [kV]
30	DGJ	Gjakova 2 110/10(20) [kV]	81000051	Bistazhini	20 [kV]
31	DGJ	Gjakova 2 110/10(20) [kV]	81000052	Ura e Terezive	20 [kV]
32	DGJ	Gjakova I 35/10(20) [kV]	80080054	Skivjani	20 [kV]
33	DGJ	Gjakova I 35/10(20) [kV]	80080053	Ponosheci	20 [kV]
34	DGJ	Gjakova I 35/10(20) [kV]	80080007	Dobroshti	20 [kV]
35	DGJ	Gjakova I 35/10(20) [kV]	80080052	Piskota 2	20 [kV]
36	DGJ	Gjakova I 35/10(20) [kV]	80080051	Piskota 1	20 [kV]
37	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082055	Bellanica	20 [kV]
38	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082051	Caralluka	20 [kV]
39	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082008	Banja	20 [kV]
40	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082007	Kijeva	20 [kV]
41	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082052	Mirusha	20 [kV]

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 22 prej 44
		Versioni	1.0

42	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082053	Malisheva 1	20 [kV]
43	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082054	Malisheva 2	20 [kV]
44	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082006	Dragobili	20 [kV]
45	DGJ	Malisheva 35/10 [kV]	82082059	TMK Spitali	20 [kV]

2.4.3 Daljet në proces të implementimit për konvertim në 20 [kV] gjatë vitit 2026

Distrikti Pejë: Barani

Distrikti Mitrovicë: Daljet nga NS Skenderaj: Turiqevci, Llausha, Likovci, Qirezi

Distrikti Gjakovë: Dalja 2 - Cermjani, Beci, Ereniku

Distrikti Ferizaj: Kosovapetroli

Distrikti Prishtinë: Projektet investive në Prishtinë, të paraqitura më poshtë janë në proces të implementimit edhe në vitin 2026:

- Daljet e reja 1 dhe 3 ndërmjet Prishtina 2 dhe 3
- Daljet e reja 1 dhe 2 ndërmjet Prishtina 3 dhe 5
- Daljet e reja 1 (Përparimi), 2 (Qyteza Pejton) dhe 5 (Fakulteti Filozofik) ndërmjet Prishtina 3 dhe Prishtina 6;
- Daljet e reja 1 & 2 Arbëria nga Prishtina 3
- Daljet e reja 1, 3 dhe 4 nga Prishtina 5


Në projektet e paraqitura më poshtë investimet kanë përfunduar dhe në vitin 2026 do të konvertohen në 20[kV];

- Daljet e reja 3 (Kroi i Bardhë), 4 (Dardania) dhe 6 (Ulpiana) nga Prishtina 6, Daljet e reja 1, 2 dhe 3 ndërmjet Prishtina 2 dhe 5
- Daljet e reja 2 dhe 5 nga Prishtina 5 & Prishtina 5 - Dega e Butovcit
- Daljet e re 2 ndërmjet Prishtina 2 dhe 3

Këto dalje, në të cilat është punuar gjatë vitit 2025, janë përfshirë edhe në tabelën e mësipërme në kapitullin “Projektet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe statusi i tyre”, me emërtimet specifike për secilin projekt.

2.4.4 Projektet e planifikuara dhe të aprovuara në vitin 2025, implementimi i të cilave do të vazhdoj edhe në vitin 2026

Vitet e fundit OSSH-ja ka pasur sfida që kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në aftësinë për të përmbushur premtimet për implementimin e projekteve sipas planeve dinamike të parapara. Edhe pse planifikimi është bërë në mënyrë të kujdesshme, prapë se prapë një numër faktorësh ka kontribuar në kohëzgjatjen e implementimit të këtyre projekteve. Është e rëndësishme të shprehim në mënyrë transparente këto sfida për të siguruar kuptim të rrjedhshëm të vështirësive gjatë fazës së implementimit të projekteve.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 23 prej 44
		Versioni	1.0

Përballë këtyre sfidave, OSSh mbetet e përkushtuar për të kapërcyer këto pengesa për të arritur rezultate sa më të suksesshme.

Sfidat në të cilat OSSh-ja ka hasur gjatë implementimit të projekteve:

- Sigurimi i lejeve nga Komuna dhe Ministria e Infrastrukturës
- Mungesa e Fuqisë Punëtore
- Problemet me konsumatorë

Projektet e planifikuara dhe të aprovuara në vitin 2025, implementimi i të cilave do të vazhdoj edhe në vitin 2026 janë:

Distrikti Gjakovë: Dejani

Distrikti Mitrovicë: Brgjani

Distrikti Pejë: Vitomirica (Pjesërisht)

Distrikti Prizren: Zhupa, Hasi II, Bresana.

Distrikti Ferizaj: Rahovica, Jezerci (Pjesërisht), Carraleva (Pjesërisht)

Projektet të cilat janë planifikuar dhe aprovuar për periudhën 2025-2026 janë:


Distrikti Pejë: Onix & Vrella

Distrikti Ferizaj: Sllovia, Gadime, Kraishta

Distrikti Pejë: Radavci & Dalja e re Radavci 1

Distrikti Prizren: Rahoveci & Rruga e Nashecit

Distrikti Mitrovicë: Stacioni Hekurudhor & Novolani

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 24 prej 44
		Versioni	1.0

3.PROJEKTET NË TENSION TË ULËT

3.1 Projektet për zgjerim dhe përforcim të rrjetit 0.4 [kV]

Në gjithë rrjetin e OSSH-së, ka pjesë të rrjetit të cilat kërkojnë investime për shkak të infrastrukturës së vjetër. Në mënyrë që të investohet në zonat më kritike, analiza është bërë duke marrë parasysh kriteret e prioriteteve për zgjedhjen e projekteve.

Qëllimet kryesore të projekteve për përforcim të rrjetit janë:

- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimi i humbjeve teknike, dhe
- Qasje më e lehtë në pikën matëse dhe reduktim i humbjeve jo-teknike

Investimet e bëra në projektet e tensionit të ulët përfshijnë:


- Ndërtimi i transformatorëve distributiv të rinj 10(20)/0.4 [kV] në një regjion apo më shumë ku vlera e humbjeve teknike dhe jo-teknike në rrjetin e tensionit të ulët është shumë e madhe
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues 10 [kV] deri te transformatori i ri
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues ose ndërtimi i rrjetit të ri në TU
- Montimi i kutive (kuadrove) nëpër shtylla nëse është rrjet ajror dhe nëpër kuadro të tokës nëse është rrjet nëntokësor
- Vendosja, gjegjësisht bartja e njehsorëve prej shtëpive për t'u vendosur nëpër kuadrot e montuar në shtylla
- Ndërrimi i njehsorëve mekanik me ata 'të mençur', dhe
- Montimi i PLC-ve

Përfitimet e pritshme përfshijnë: furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmirësimin e kualitetit të tensionit, reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike dhe përmirësimin e topologjisë së rrjetit. Projektet e vitit 2025 do të jenë në proces të implementimit edhe gjatë vitit 2026 dhe 2027.


Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur listën e projekteve.

Tabela 16. Lista e projekteve në tensioni e ulët

Distrikti	Emri I Daljes	Emri i TS	Kodi I TS	Vitet
DFE	J03 Jezerci	TS Manastirc-Lagje Muhaxherve	40042003042	2026
DFE	J03 Jezerci	TS Jezerc - Ukzmajl	40042003061	2026
DFE	J03 Jezerci	T.S.Xhamija, Balaj	40042003174	2026
DFE	J14 Rahovica	TS Talinovci I Muhaxherëve (Kulla)	40000014012	2026
DFE	J14 Rahovica	TS Bibaj (portallci-Milazim Alija)	40000014163	2026
DFE	J14 Rahovica	TS Mirasal (xhamija)	40000014150	2026
DFE	J14 Rahovica	TS Rahovic (Zariqët)	40000014026	2026
DFE	J04 Carraleva	Shtime - Wiliam Woker	41046004046	2026
DGJ	J10 Denji	QIFLAKU I	82081007017	2026

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 25 prej 44
		Versioni	1.0

DPE	J02 Vitomirica	Baliqtë	50000010018	2026
DPE	J02 Vitomirica	Domi	50000010010	2026
DPE	J02 Vitomirica	Katundi i ri	50000010007	2026
DPZ	J03 Hasi II	Romaja I	30034003011	2026
DPZ	J26 Zhupa	Lubinja e poshtme II	31000026025	2026
DPZ	J26 Zhupa	Llokvica	31000026012	2026
DPZ	J26 Zhupa	Pllanjan I	31000026002	2026
DPZ	J26 Zhupa	Mushnikova II	31000026033	2026
DPZ	J04 Shkolla normale	Tusus III	30033004013	2026
DPZ	J09 Bresana	Zaplugje I	30036007024	2026
DPZ	J09 Bresana	Bresana III	30036007014	2026
DPZ	J09 Bresana	Bresana II	30036007013	2026
DMI	J25 Ibër Lepenci - Mitrovicë	Ibri	70000012001	2026
DMI	J25 Ibër Lepenci - Mitrovicë	Zhabar i Ulet-1 Kulla (Enveri)	70000012002	2026
DMI	J05 Stadioni	Migjeni	70000009003	2026
DMI	J06 Novolani	Bukosh-1(Krasaliqët)	73000005001	2026
DMI	J06 Novolani	Shallci-1	73000005026	2026
DMI	J06 Novolani	TSSh Zhabart	73000005028	2026
DMI	J07 Stacioni Hekurudhor	Dolak (lagja Kuqi)	73000004030	2026
DMI	J07 Stacioni Hekurudhor	Gurbardh	73000004026	2026
DMI	J06 Novolani	Novolani-2 (te Shkolla)	73000005006	2026
DFE	J21 Gadime	TS Gadime e epërme - kulla	41000013136	2026
DFE	J21 Gadime	TS Gadime e ulët - Shpella	41000013134	2026
DPE	J05 Radavci	Fezajt	50000004028	2026
DPE	J05 Radavci	Fierza I	50000004017	2026
DPE	J11 Vrella	Vrellë Teuta I (VV3)	54000002018	2026
DPE	J09 Onixi	Blinda Banje B.Metaj	50052006010	2026
DPE	J09 Onixi	Baic Ujrat e zeza	50052006037	2026
DPZ	J15 Rahoveci	Landovica I	30000015016	2026
DGL	J08 Binqa	TS-Zijaji	61067008003	2026-2027
DGL	J06 Smira	Drobesh-Sabiti-TS-024	61067006024	2026-2027
DGL	J05 Frigoriferi	Te Baja -Bazeni	60061005062	2026-2027
DMI	J20 Studime - Grupi i Bizneseve	TSB Mbi asfalt	73000013008	2026-2027
DPE	J07 Klina I	Mbi Stacion Kulla	52000005002	2026-2027
DPE	J09 Qyteti 2	TS 8/2	51000013003	2026-2027
DPR	J07 Podujeva 2	Shaban Shala	14000002011	2026-2027
DPR	J12 Kodra e Trimave 7	Ismet Asllani	13000006085	2026-2027

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 26 prej 44
		Versioni	1.0

DPR	J13 Fabrika e kasetave	Hajvalia vorret	19000039147	2026-2027
DPR	J03 Palaj	Lajthishte	18024001038	2026-2027
DPR	J22 Vragoli	Ashkalit II	15018007085	2026-2027
DPZ	J29 Kamenica	Kamenica III/2	31000029001	2026-2027
DPZ	J03 Ortakoll 2	Durmish Asllani IV	30000003005	2026-2027

Projektet me ngjyrë të kaltër janë projektet e planifikuara dhe të aprovuara në vitin 2025, implementimi i të cilave do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2026.

Në kuadër të projekteve të tensionit të ulët përfshihen edhe tri projektet e mëposhtme

- **Projekti: Janjevë**

Në figurën 12 janë paraqitur projektet Janjevë (te Kisha), Janjevë (te Shkolla), Janjevë (TS Policia) dhe Janjevë (TS i Ri), të cilat do të realizohen në kuadër të projektit “Riparimi i ndriçimit publik dhe rrjetit elektrik në Janjevë”, që do të implementohet nga UNDP në bashkëpunim me komunën e Lipjanit.

Në figurën e mëposhtme, janë paraqitur në Google Earth zonat e investimit në rrjetin e TU (sipërfaqet me ngjyrë të gjelbër dhe të kaltër), si dhe segmentet e propozuara për investim në linjat e TM që do të furnizojnë TS-at përkatës. Në projektin Janjevë (TS Policia) është përfshirë vetëm pjesa e tensionit të mesëm.





Figura 12. Projektet që do të realizohen në kuadër të projektit “Riparimi i ndriçimit publik dhe rrjetit elektrik në Janjevë”.

UNDP-ja planifikoi të mbulonte të gjitha projektet, megjithatë, pas verifikimit, buxheti i tyre i planifikuar nuk i mbulonte të gjitha. Për këtë arsye, ata kërkuan që projekti TS Virovci (pjesa e tensionit të ulët dhe linja e tensionit të mesëm) dhe TS Policia (vetëm tensioni i ulët) të përfshiheshin në planin e KEDS-it. Në figurën 2 për projekti Janjevë (TS Virovci) është paraqitur në Google Earth zona e investimit në rrjetin e TU (sipërfaqja me ngjyrë të gjelbër), si dhe segmentet e propozuara për investim në rrjetin e TM që do të

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 27 prej 44
		Versioni	1.0

furnizojnë TS-in përkatës. Në figurën 14 është paraqitur në Google Earth zona e investimit në rrjetin e TU për projektin Janjevë (TS Policia).



Figura 13. Projekti Janjevë (TS Virovci)



Figura 14. Projekti Janjevë (TS Policia)

- **Projekti: Cërnusha**

Në fshatin Cërnushë sipas informatave nga terreni, ka pasur rrjet të energjizuar që nga viti 1968, që e dëshmojnë edhe shtyllat ekzistuese. Në figurën e mëposhtme, në Google Earth, është paraqitur zona e investimit në rrjetin e TU (sipërfaqja me ngjyrë të gjelbër). Është planifikuar të instalohet një TS i ri 100kVA, dhe për furnizimin e këtij TS-i do të ndërtohet linja ajrore me shtylla të betonit me përçues Al/Çe 50/8 [mm²] (linja me ngjyrë të kaltër).


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 28 prej 44
		Versioni	1.0



Figura 15. Projekti Cërnushë

3.2 Projektet e planifikuara për vitin 2026 – Veriu i Kosovës


Tabela 17. Lista e projekteve të planifikuara për vitin 2026 në Veriun e Kosovës

Distrikti	Kodi i TS-it	Emri i TS-it	Sins [kVA]	Numri i konsumatorëve
DMI	70000104029	Zhazh 2	160	34
DMI	70000104028	Zhazh1	100	13

4.PROJEKTET NË RRJET TË MENÇUR

Në një periudhë kur rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike është në zgjerim dhe përballje me kërkesa gjithnjë në rritje, integrimi i teknologjive të rrjetit të mençur është bërë një strategji kyçe për rritjen e efikasitetit, besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit. Gjatë vitit 2026, Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka thelluar përkushtimin e tij për dixhitalizimin e rrjetit përmes zbatimit të teknologjive të avancuara që kontribuojnë në krijimin e një infrastrukture energjetike moderne, fleksibile dhe të sigurtë.

OSSH, përmes investimeve të vazhdueshme, ka qenë i përqendruar në zhvillimin e sistemeve inteligjente që mundësojnë monitorim dhe kontroll në kohë reale, duke shfrytëzuar teknologji të avancuara për matje, komunikim, dhe automatizim. Kjo qasje synon të transformojë rrjetin shpërndarës në një sistem të digjitalizuar dhe të integruar, i cili jo vetëm që ndjek performancën e rrjetit në kohë reale, por edhe mund të reagojë në mënyrë adaptive ndaj ndryshimeve ose problemeve që shfaqen në rrjedhën e energjisë. Përdorimi i analitikës së të dhënave dhe automatizimit të proceseve operacionale ndihmon në optimizimin e rrjedhës së energjisë, në zbutjen e defekteve dhe në krijimin e një rrjeti më të qëndrueshëm për të ardhmen. Kjo infrastrukturë e avancuar rrit ndjeshëm dukshmërinë dhe kontrollin operacional, duke mundësuar identifikimin dhe adresimin e menjëhershëm të defekteve apo anomalive, minimizimin e kohës së ndërprerjes dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 29 prej 44
		Versioni	1.0

Menaxhimi i sistemit elektroenergjetik shpërndarës paraqet një sfidë të vazhdueshme, veçanërisht në raport me nevojën për kontroll të saktë, mbikëqyrje të përhershme dhe mirëmbajtje efikase të rrjetit. Në këtë drejtim, funksionalitetet moderne të rrjetit të mençur përfshijnë integrimin e sistemeve të mbrojtjes, automatizimin e nënstacioneve, ndërhyrjet në rrjetin ekzistues, si dhe instalimin e pajisjeve të reja inteligjente, të cilat janë pjesë përbërëse e planeve të investimeve të parashikuara për vitet në vijim.

Fokusi strategjik i OSSH në drejtim të rrjetit të mençur përputhet ngushtësisht me objektivat afatgjata të qëndrueshmërisë mjedisore, inovacionit teknologjik dhe orientimit drejt konsumatorit. Përmes kësaj qasjeje, kompania synon jo vetëm përmirësimin e performancës teknike të rrjetit, por edhe ofrimin e një shërbimi më cilësor për konsumatorët fundorë, duke e vendosur ata në qendër të transformimit energjetik

Në tabelën 19 janë paraqitur projektet të cilat do të realizohen gjatë vitit 2026.


Tabela 18. Projektet në kategorinë Smart Grid

Projekti	Sasia
Ndërrimi i mbrojtjeve rele në nënstacione	200
Instalimi i SCADA-ës në SSh	14
Mirëmbajtja e Sistemit Ekzistues SCADA	1
Instalimi i FID-ave	6
Instalimi i rimbyllësve automatik	10
Instalimi i Seksionalizatorëve	10
Dalje të mencura (PP – Full Smart Feeder)	1
Pajisje për testim	1
Sistemi Informatik Gjeografik (GIS)	1
Totali	244

Më poshtë për secilën nga projektet e përfshira në kategorinë “Smart Grid” do të paraqiten shpjegime më të detajuara.

Ndërrimi i mbrojtjeve rele në nënstacione: Një nga pjesët më të rëndësishme të sistemit shpërndarës është pjesa e sistemit të mbrojtjes sepse është shumë e rëndësishme që sistemi të mbrohet nga defektet e ndryshme që mund të ndodhin. Në sistemin shpërndarës të Kosovës në nivelin e tensionit të mesëm 35 [kV], 20 [kV], 10 [kV] dhe 6 [kV] ekziston një numër i madh i releve mbrojtëse të vendosura në dalje furnizuese, ardhje apo trafofusha me qëllim të mbrojtjes nga lidhjet e shkurta apo mbingarkesat.

Përçindja më e madhe e releve të vendosura në nënstacione kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë të tyre të operimit dhe duke e ditur natyrën kritike dhe të ndjeshme të kësaj pajisje atëherë OSSh gjatë vitit 2024 dhe 2025 ka ndërruar një numër të konsiderueshëm të releve dhe do të vazhdoj që edhe gjatë vitit 2026 të bëj ndërrimin e releve sipas planit dinamik të njësisë përkatëse. Arsye se pse OSSh parasheh që të vazhdoj me ndërrimin e releve nëpër nënstacione janë:

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 30 prej 44
		Versioni	1.0

- Reletë ekzistuese kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë për operim
- Aftësitë teknike të releve janë duke u zvogëluar krahas operimit të tyre
- Reletë ekzistuese të cilat janë propozuar për ndërrim janë rele jo të drejtuara. Reletë ekzistuese mund të reagojnë si shkak i lidhjeve të shkurta të cilat mund të ndodhin në daljet tjera.
- Ndërsa reletë të cilat parashihen të blihen do të jenë rele të drejtuara të cilat do të reagojnë apo do të detektojnë defektin apo lidhjet e shkurta vetëm në një drejtim dhe nuk do të reagojnë atëherë kur defekti është në drejtim tjetër.
- Në reletë ekzistuese mundësia e rregullimit të parametrave të mbrojtjes rele për lidhjet e shkurta me tokë në rele është 0.1xIn, që paraqet një disavantazh shumë të madh për parametrizimin dhe mbrojtjen e mirëfilltë.
- Reletë ekzistuese përfshijnë më pak funksione të mbrojtjes se sa reletë e propozuara për ndërrim.

Gjatë vitit 2026 parashihen që të ndërrohen gjithsej 200 rele mbrojtëse.

Tabela 19. Ndërrimi i releve në nënstacione

Nr.	Viti	Sasia
1	2026	200


Përfitimet të cilat do të vijnë pas ndërrimit të mbrojtjeve rele në nënstacionet kryesore janë të shumta, mirëpo vlen të përmenden këto përfitime:

- Do të rritet siguria e sistemit të shpërndarjes
- Do të zvogëlohet numri i ndërprerjeve apo rënieve të padëshiruara në linjat 35 [kV], 20 [kV], 10 [kV] dhe 6 [kV]
- Do të zvogëlohet numri i ndërprerjeve të padëshiruara të linjave të ‘shëndetshme’
- Ulja e kostos dhe rritja e cilësisë së energjisë
- Mundësia e rregullimit, parametrizimit të mbrojtjeve rele do të jetë më e madhe
- Përdorimi i një numri më të madh të funksioneve të mbrojtjeve rele
- Do të rritet selektivitetit ndërmjet releve në kufirin OSSH dhe OST

Instalimi i sistemit SCADA në stabilimente: Njëra ndër synimet kryesore të OSSH-së është që të rrisë besueshmërinë dhe të zvogëloj kohën e ndërprerjeve sa i përket furnizimit me energji elektrike. Njëra ndër mënyrat e shumta për të arritur një objektivë të tillë, është instalimi i sistemit SCADA në stabilimente apo nënstacione sekondare. OSSH pas realizimit të monitorimit dhe kontrollit të rrjetit në nivelin e tensionit të mesëm, ka vazhduar me zbatimin e këtij procesi në nivel të tensionit të ulët. Në rrjetin e shpërndarjes ka një numër të madh të stabilimenteve shpërndarëse 10(20)/0.4 [kV] të vendosura në lokacione të ndryshme në të cilat mund të instalohet sistemi SCADA.

Gjatë vitit 2023-2024 OSSH ka përfshirë numrin më të madh të stabilimenteve në sistemin aktual të kontrollit duke arritur që të realizoj me sukses instalimin e sistemit SCADA në stabilimentet kryesore të rrjetit elektrik. Me anë të këtij instalimi OSSH arrinë që t'i monitoroj dhe kontrolloj pikat kyçe të rrjetit elektrik duke pasur qasje të plotë edhe në degëzimet e daljeve 10-20 [kV] në stabilimente.

Sistemi SCADA gjatë vitit 2026 planifikon që të zgjerohet edhe më tutje duke përfshirë edhe 14 stabilimente të tjera të cilat do të identifikohen varësisht parametrave bazë të selektimit të pikave se ku do të instalohet sistemi i tillë.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 31 prej 44
		Versioni	1.0

Pra gjatë vitit 2026 sistemi do të realizohet në 14 stabilimente.

Përditësimi, Implementimi dhe Projektimi Inxhinierik i SCADA-s: Sistemi SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition) përbën një nga komponentët më kritikë për funksionimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë. Ky sistem është aktiv për më shumë se 7 vite, duke operuar vazhdimisht dhe duke luajtur një rol kyç në garantimin e sigurisë operationale, efikasitetit të menaxhimit të rrjetit dhe kualitetit të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët. SCADA është komponent kyç për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin e Kosovës. Çdo defekt në funksionimin e sistemit SCADA ndikon në aftësinë për të menaxhuar ngarkesat, për të identifikuar dhe reaguar ndaj avarive, dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor. Në kontekstin e zhvillimeve të fundit, si rritja e kërkesës për energji, dekarbonizimi i sektorit energjetik dhe integrimi i burimeve të ripërtëritshme, sistemi SCADA duhet të jetë plotësisht funksional, i mirëmbajtur dhe i përditësuar për të përmbushur këto sfida të reja.

Pajisjet ekzistuese harduerike dhe komponentët softuerikë të këtij sistemi kanë arritur ose tejkaluar ciklin e tyre të rekomanduar të jetës funksionale, ndaj përditësimet teknologjike dhe përkrahja teknike janë domosdoshmëri strategjike dhe operative.

Arsyet kyçe për përditësimin e domosdoshëm të sistemit SCADA janë:

Tejkalimi i ciklit jetësor të pajisjeve harduerike:

- Shumica e pajisjeve kanë kaluar ciklin standard të operimit (zakonisht 5–7 vite për komponentë kritikë industrialë).
- Rritet rreziku i dështimeve teknike, duke ndikuar drejtpërdrejt në vazhdimësinë dhe sigurinë e operationeve.
- Furnizimi me pjesë rezervë për pajisjet ekzistuese po bëhet gjithnjë e më i vështirë dhe me kosto më të lartë, për shkak të daljes nga prodhimi ose mbështetja nga prodhuesit (End of Support/Life).

Nevoja për përditësim të platformave softuerike:


- Mungesa e përditësimeve rrit rrezikun për sulme kibernetike, të cilat për sistemet kritike si SCADA mund të kenë pasoja serioze për gjithë rrjetin.
- Softuerët e përditësuar ofrojnë funksionalitete të avancuara për automatizim, raportim, analizë të avancuar të të dhënave (analytics) dhe integrim më të lehtë me sisteme të tjera operative

Siguria kibernetike dhe përputhshmëria me standardet ndërkombëtare:

- Sipas standardeve ndërkombëtare si IEC 62443, NIST SP 800-82 dhe kërkesave të rrjeteve energjetike moderne, sistemet SCADA duhet të kenë arkitekturë të sigurt, kontrolle të aksesit dhe mekanizma për mbrojtje ndaj sulmeve të brendshme dhe të jashtme. Prandaj është e nevojshme që sistemi të përditësohet kohë pas kohe në mënyrë që të jetë i mbrojtur.

Kostoja e mospërditësimit është shumë më e lartë se ajo e përditësimit:

- Mospërditësimi dhe zhvillimi inxhinierik i sistemit SCADA sjell pasoja financiare shumëfish më të mëdha, përfshirë ndalje të papritura të sistemit, humbje në furnizim, ndërprerje të të dhënave.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 32 prej 44
		Versioni	1.0

- Ndërhyrjet emergjente janë më të shtrenjta, më të vështira për t'u koordinuar dhe mund të përfshijnë kosto të larta për zëvendësim të pajisjeve në kushte urgjente.

Duke analizuar në mënyrë të gjithanshme gjendjen aktuale të sistemit SCADA, rëndësinë e tij për rrjetin elektroenergjetik të Kosovës dhe sfidat që lidhen me kohëzgjatjen e funksionimit të tij, është e qartë se përditësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi përbëjnë një domosdoshmëri operacionale, teknike dhe strategjike.


Sistemi SCADA nuk është thjesht një komponent teknik – ai është sistemi kryesor digjital i operimit të rrjetit, që siguron monitorimin në kohë reale, ndërhyrjen e menjëhershme në rast të avarive, optimizimin e ngarkesave dhe menaxhimin efikas të rrjetit të shpërndarjes. Çdo degradim në performancën e këtij sistemi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe sigurinë teknike të rrjetit.

Duke qenë se disa nga pajisjet dhe platformat ekzistuese kanë tejkaluar jetën e tyre funksionale të rekomanduar, rritet ndjeshëm rreziku për dështime sistemike, ndërprerje të paautorizuara të operimit, humbje të të dhënave kritike, si dhe ekspozim ndaj rreziqeve kibernetike. Masat parandaluese, përditësimi i softuerëve dhe zëvendësimi i pajisjeve përbëjnë një investim të nevojshëm për të shmangur pasoja shumë më të mëdha në të ardhmen si në aspektin financiar, ashtu edhe në atë të reputacionit institucional dhe operimit të sigurt të rrjetit. Në një kohë kur rrjeti i shpërndarjes po përballet me sfida të reja përfshirë integrimin e burimeve të ripërtëritshme, rritjen e konsumit, nevojën për automatizim më të lartë dhe kërkesat për efikasitet energjetik sistemi SCADA duhet të jetë i përgatitur për të përmbushur këto kërkesa të reja. Kjo është e mundur vetëm nëse ky sistem trajtohet në mënyrë profesionale, përditësohet rregullisht dhe evoluon në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe standardet ndërkombëtare.

Instalimi i Detektorëve Tregues të Defekteve (FID): Duke qenë se sistemi elektrik i shpërndarjes është një sistem më i ndërlikuar dhe duke e ditur se elementet e këtij sistemi janë të shpërndara nëpër shumë pika qofshin ato të hapura apo të mbyllura mund të themi se sistemi i shpërndarjes është vazhdimisht i ekspozuar ndaj dukurive të defekteve për arsye të ndryshme, si goditja e rrufesë, dështimi i pajisjeve, kushtet e këqija atmosferike etj.

Të gjitha dukuritë të cilat shkaktojnë prishje apo dështime të rrjetit të shpërndarjes ndikojnë në besueshmërinë e sistemit dhe rezultojnë në riparime ndonjëherë të shtrenjta, humbje të produktivitetit dhe humbje të energjisë për klientët. Meqenëse defekti është i paparashikueshëm, kërkohet një vendndodhje dhe izolim i shpejtë i defektit për të minimizuar ndikimin e këtyre defekteve në sistemet e shpërndarjes. Në shumicën e këtyre prishjeve janë ekipet e rrjetit dhe mirëmbajtjes ato që kanë punën më të madhe për t'i eliminuar këto prishje apo defekte dhe për të rikthyer më pas furnizimin me energji elektrike për konsumatorë. Mirëpo tendenca e OSSH-së është që të përdorë pajisje dhe metoda të ndryshme për të lokalizuar defektet e ndryshme që ndodhin në rrjet. Një nga këto pajisje janë edhe detektorët tregues të prishjeve (defekteve). Gjatë vitit 2026 parashihen të instalohen 6 detektorë të tillë në linja 35 [kV].

Instalimi i rimbyllësve automatik: Rimbyllësi automatik është një lloj pajisje komutuese inteligjente e përdorur në automatizimin e rrjetit të shpërndarjes. Mund të zbulojë rrymën e defektit (lidhjeve të shkurta), të shkyç qarkun brenda një kohe të caktuar dhe të kryejë një numër të caktuar rimbylljesh.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 33 prej 44
		Versioni	1.0

Gjatë vitit 2023 dhe 2024 OSSh ka instaluar gjithsej 4 rimbyllës automatik në largpërçues 10(20) [kV] që përballen me defekte (avari) të shpeshta dhe që shtrihet në zona jo të përshtatshme. Kjo pajisje lejon që furnizimi të rikthehet automatikisht, pas vetëm një ose dy luhatjesh. Rimbyllësi automatik që do të instalohet do t'i kursejë kompanisë kohë dhe shpenzime të konsiderueshme.

Tabela 20. Përfitimet nga Instalimi i Rimbyllësve Automatik


Nr.	Kategoria	Përfitimi
1	Operative	Shkyçje automatike e linjës gjatë defekteve (prishjeve)
		Rimbyllje automatike pas luhatjeve të shkurtra
2	Teknike	Zbulim i menjëhershëm i defektit (prishjeve) dhe natyrës së rrymës
		Funksione të mbrojtjes dhe kontrollit të integruara
3	Ekonomike	Kursim në kohën e ndërhyrjes
		Reduktim i shpenzimeve për mirëmbajtje dhe reagim ndaj avarive
4	Efikasiteti i shërbimit	Minimizim i zonës së ndërprerjes
		Rikthim i shpejtë i furnizimit për konsumatorët
5	Menaxhimi i rrjetit	Lehtësi në lokalizimin e defektit nga ekipet e terrenit
		Integrim me sistemin SCADA (kontroll dhe monitorim në kohë reale)

Ndërsa gjatë vitit 2026 OSSh parasheh që të instaloj edhe 10 rimbyllës automatik të tjerë në zona të cilat konsiderohen problematike. Qëllimi i tërë këtij procesi është që izolohen defektet (avaritë) duke minimizuar impaktin e këtyre defekteve në furnizimin e përgjithshëm me energji elektrike për konsumatorët.

Deri më tani janë përcaktuar 7 dalje se ku do të instalohen, ndërsa gjatë vitit aktual do të përcaktohen edhe 3 dalje të tjera në bazë të numrit më të lartë të prishjeve të regjistruara.

Tabela 21. Daljet e paracaktuara për instalimin e rimbyllësve automatik

Nr.	Distrikti	Nënstacioni	Kodi i daljes	Emri i daljes
1	DFE	35/10 [kV] Kaçaniku	40043002	J07 Bobi
2	DGJ	35/10 [kV] Gjakova I	80080006	J04 Ponosheci
3	DMI	110/35/10 [kV] Vushtrria 2	73000005	J06 Novolani
4	DPE	110/35/10 [kV] Peja 1	50000009	J12 Fusha e Pejës
5	DPR	35/10 [kV] Badovci	10014001	J01 Mramor - Slivovë
6	DPR	220/35/10 [kV] Podujeva	14000010	J19 Fshatrat 2
7	DPZ	110/10 [kV] Prizreni 3	31000026	J26 Zhupa

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 34 prej 44
		Versioni	1.0

Instalimi i Seksionalizatorëve: Një seksionalizator është një pajisje mbrojtëse që vendoset në rrjetet ajrore të shpërndarjes për të izoluar seksionet me defekt pas detektimit të ndërprerjes së tensionit ose rrymës si rezultat i funksionimit të një pajisjeje mbrojtëse më lart në rrjet.

Për dallim nga rimbyllësi automatik, seksionalizatorët nuk e ndërpresin rrymën e defektit, por punojnë në koordinim me to për të identifikuar dhe izoluar seksionin me defekt pasi të jetë ndërprerë rryma nga rimbyllësi automatik. Përfitimet kryesore nga instalimi i seksionalizatorëve janë:

- Izolim më i mirë i defekteve: Lejon identifikimin dhe izolimin e saktë të segmentit me defekt, pa ndikuar pjesët e shëndetshme të rrjetit.
- Reduktim i zonës së ndërprerjes: Ndikon më pak konsumatorë
- Koordinim me autorecloser: Funksionon pas ndërprerjes së rrymës, duke lejuar rimbyllësin automatik të rikthejë furnizimin në pjesët pa defekt.
- Funksionim automatik: Rrit automatizimin e rrjetit dhe zvogëlon ndërhyrjet manuale.
- Mbështet sistemin FLISR: Thelbësor për sistemet inteligjente të lokacionit të Defekteve, izolimit dhe rikthimit të furnizimit.
- Kosto-efektiv: Redukton ngarkesën ndaj pajisjeve mbrojtëse lart në rrjet dhe shmang ndërprerjet e panevojshme.

Seksionalizatorët do të vendosen në mënyrë strategjike në daljet e tensionit të mesëm në linjat të cilat kanë degëzime të shumta veçanërisht në:

- Pikat e mesme të daljeve midis grupeve të ngarkesës
- Degëzimet në T që furnizojnë zona të ndryshme
- Zona të gjata të daljeve ose zona me defekte të shpeshta

Seksionalizatorët të cilët do të instalohen do të jenë të ‘mencur’ (me komunikim) dhe do të dërgojnë të dhëna për statusin (hapur/mbyllur/defekt) tek rikyqësi automatik pranë tij.

Kriteret kryesore për përzgjedhjen e vendosjes së seksionalizatorëve do të jenë:

- Topologjia e daljeve
- Historia e prishjeve (defekteve) në segmente të ndryshme të linjave
- Profili i ngarkesës
- Skemat ekzistuese të mbrojtjes
- Infrastruktura e komunikimit e disponueshme
- Përputhshmëria me rikycesit automatik (në parametra dhe protokolle)

Gjatë vitit 2026 OSSH synon që të instaloj 10 pajisje të tilla në rrjetin shpërndarës. Vendosja e seksionalizatorëve në rrjetin shpërndarës përmirëson ndjeshëm menaxhimin e defekteve duke mundësuar izolim të targetuar, rikthim më të shpejtë të energjisë dhe koordinim të saktë me autoreklozerët. Pajisjet si kjo janë elementë kyç në drejtim të rrjeteve të mençura dhe në rritjen e besueshmërisë së rrjetit elektrik.


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 35 prej 44
		Versioni	1.0

Tabela 22. Instalimi i seksionalizatorëve në dalje

Nr.	Distrikti	Nënstacioni	Emri i daljes
1	DGL	110/10 [kV] Kamenica	Strezovci
2	DPE	110/35/10 [kV] Peja 1	Radavci
3	DPR	220/35/10 [kV] Drenasi	Llapushniku
4	DFE	35/10 [kV] Kaçaniku	Bobi
5	DGJ	35/10 [kV] Gjakova I	Ponosheci
6	DMI	110/35/10 [kV] Vushtrria 2	Novolani
7	DPE	110/35/10 [kV] Peja 1	Fusha e Pejës
8	DPR	35/10 [kV] Badovci	Mramor - Slivovë
9	DPR	220/35/10 [kV] Podujeva	Fshatrat 2
10	DPZ	110/10 [kV] Prizreni 3	Zhupa

Daljet e mencura. Gjatë vitit 2026 OSSH do të tentoj që të implementoj sistemin e rrjetit të mencur në një dalje të tërë. Qëllimi i këtij projekti është që një dalje ekzistuese e rrjetit të shpërndarjes (në tension të mesëm dhe të ulët) të transformohet në një dalje tërësisht të automatizuar, të monitoruar dhe të menaxhueshme në mënyrë digjitale në kohë reale, përmes instalimit të pajisjeve inteligjente në të gjitha pikat kyçe duke filluar nga nënstacioni i daljes së TM, deri te kabllot dhe kabinetet e TM/TT në teren dhe pikat fundore të furnizimit.


Në kuadër të përpjekjeve për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe rritjen e nivelit të digjitalizimit dhe automatizimit operacional, ky projekt synon transformimin e një daljeje ekzistuese të tensionit të mesëm (TM) në një dalje tërësisht të mençur dhe inteligjente (Full Smart Feeder), duke përfshirë në mënyrë të integruar edhe rrjetin përkatës të tensionit të ulët (TU).

Ky pilot projekt do të shërbejë si model referues për digjitalizimin e daljeve të tjera të rrjetit, në përputhje me direktivat strategjike për ndërtimin e një rrjeti të mençur, efikas dhe të qëndrueshëm, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të avancuara ndërkombëtare në sektorin energjetik.

Qëllimi i projektit është të mundësojë:

- Monitorim dhe komandim në kohë reale të të gjitha elementeve të rrjetit në atë dalje,
- Identifikim automatik i defekteve, segmentim të zonave të prishjes dhe rikthim të furnizimit në pjesët jo të afektuara
- Matje dhe analizë të vazhdueshme të parametrave teknike, në mënyrë që të optimizohet funksionimi i rrjetit dhe të reduktohen humbjet teknike dhe jo-teknike
- Integrim i plotë i sistemit të komunikimit dhe sigurisë kibernetike, duke garantuar transmetim të besueshëm të të dhënave drejt sistemeve qendrore si SCADA, DMS dhe AMI.

Projekti synon të krijojë një dalje të automatizuar dhe të monitoruar në të gjitha segmentet e saj:


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 36 prej 44
		Versioni	1.0

- Në nivelin e tensionit të mesëm, përmes instalimit të sistemit SCADA, seksionalizatorëve, FID-ve, sensorëve të rrjedhës dhe tensionit, motorizimit të disa pajisjeve shtesë.
- Në nivelin e tensionit të ulët, përmes instalimit të matësve të mençur (smart meters), pajisjeve monitoruese për TU, njërive të komunikimit me platformën AMI etj.
- Gjithashtu, parashikohet vendosja e pajisjeve të mençura në pikat kyçe të rrjetit, për të ndjekur performancën e rrjetit në kohë reale, për të marrë vendime automatike në rast të defekteve, dhe për të menaxhuar më mirë ngarkesat, tensionet dhe balancimin e fazave.

Metodologjia e implementimit është planifikuar në 4 faza kryesore, ku aktivitetet kryesore në pika më të zgjeruara janë dhënë në tabelën më poshtë:

Tabela 23. Metodologjia e implementimit te FULL Smart Feeder

Faza	Përshkrimi	Aktivitetet Kryesore
Faza 1	Planifikimi dhe projektimi	Analizë e detajuar e daljes së zgjedhur (rrjet, kapacitete, konsumatorë)
		Hartimi i skemave elektrike dhe të komunikimit
		Përzgjedhja e teknologjisë dhe furnitorëve në përputhje me standardet
Faza 2	Instalimi i pajisjeve në TM dhe integrimi në SCADA	Instalimi i pajisjeve në nënstacione dhe pika të ndërprerjes në terren
		Testim i komunikimit dhe konfigurim i mbrojtjeve
		Integrim me sistemin ekzistues SCADA
Faza 3	Instalimi i pajisjeve në TU dhe aktivizimi i monitorimit	Instalimi i matësve të mençur dhe paneleve inteligjente
		Aktivizimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave në AMI
		Trajnimi i stafit për monitorim të rrjetit TU
Faza 4	Testim, kalibrim dhe vënia në funksion	Testim i plotë funksional
		Simulime për avari, automatizim dhe rikthim të tensionit
		Vënia e plotë në funksion

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 37 prej 44
		Versioni	1.0




Figura 16. Zbatimi i FLISR në dalje.

Përmes këtij projekti, priten këto rezultate kryesore:

- ❖ Reduktim i kohës së ndërprerjeve dhe përmirësim i besueshmërisë së rrjetit.
- ❖ Mundësi për vendimmarrje në kohë reale, me bazë në të dhëna të sakta dhe të vazhdueshme.
- ❖ Ndërveprim i plotë me sistemet digjitale: SCADA, AMI, GIS, DMS
- ❖ Krijimi i një baze për zgjerimin e konceptit të rrjetit të mençur në shkallë më të gjerë në të ardhmen.
- ❖ Mundësi të aplikimit të sistemit FLISR (Fault Location, Isolation and Service Restoration - Lokacioni i Defektit, Izolimit dhe Rikthimi i Furnizimit) gjatë procesit të operimit

Pajisje për testim: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), në kuadër të strategjisë së tij për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, rritjen e efikasitetit operativ dhe përmirësimin e sigurisë teknike të infrastrukturës, synon të investojë në blerjen e pajisjeve të specializuara dhe të teknologjisë së avancuar të domosdoshme për funksionimin e disa proceseve operative dhe të mirëmbajtjes. Këto pajisje janë të domosdoshme për të mbështetur aktivitetet ditore të mirëmbajtjes dhe operimit të rrjetit, si dhe për të mundësuar një menaxhim proaktiv dhe parandalues të aseteve kritike të sistemit. Investimet e planifikuara përfshijnë pajisje për monitorim dhe analizë të avancuar të transformatorëve të fuqisë, pajisje mbrojtëse për ndalimin e rrymave të shkurtër, si dhe teknologji ajrore për inspektim inteligjent të rrjetit përmes dronëve.


	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 38 prej 44
		Versioni	1.0

Tabela 24. Pajisjet për Testim

Nr.	Pajisja	Sasia
1	LIDAR për Vintra Drone	1
2	Is-limiter (për lidhje të shkurtëra në rrjet)	1
3	DGA për transformatorë të fuqisë	1
4	Pajisja e Testimit të Reaktancës së Transformatorit	1
Total		4

LIDAR për Vintra Drone: LIDAR (Light Detection and Ranging) është një sensor me precizion të lartë që përdoret në dronë për krijimin e modeleve 3D të mjedisit, matje të saktë të distancave dhe inspektime të infrastrukturës energjetike nga ajri. Kjo pajisje mundëson:


- ❖ Inspektim ajror të linjave dhe trasesë së rrjetit TM/TU me saktësi të lartë, sidomos në terrene të paarrishme ose të vështira për ekipet në terren.
- ❖ Identifikim automatik të rreziqeve dhe pengesave në afërsi të përçuesve (vegjetacion, ndërtime pa leje etj.), duke parandaluar avari të mundshme.
- ❖ Krijimi të hartave digjitale 3D të rrjetit për GIS, planifikim investimesh dhe dokumentim teknik.
- ❖ Integrim me analitikën e Vintra Drone (pajisje të cilën OSSH e posedon), duke mundësuar inspektim inteligjent dhe automatik.
- ❖ Rritje e efikasitetit operativ dhe reduktim i kostove për inspektime manuale periodike.

Is-limiter (për lidhje të shkurtëra në rrjet): Is-limiter është një pajisje mbrojtëse që izolon automatikisht rrymat e larta të shkurtër, duke mbrojtur pajisjet dhe infrastrukturën kritike të rrjetit në rast avarie të rëndë. Duke pasur parasysh nivelin e rrymave të lidhjeve të shkurtra që ndodhin në rrjet OSSH do të blejë vetëm një pajisje të tillë për të parë ndikimin e saj. Kjo pajisje do të ndihmojë në:

- ❖ Reduktimin e ndikimit të rrymave të lidhjeve të shkurtëra në transformatorë, kablllo dhe pajisje ndërlidhëse, duke zgjatur jetëgjatësinë e tyre.
- ❖ Parandalon përhapjen e mundshme të defektit në zona të tjera.

DGA për transformatorë të fuqisë: DGA (Dissolved Gas Analysis) përdoret për të analizuar gazrat e tretur në vajin e transformatorit, që janë indikatorë të hershëm të problemeve të brendshme.

- ❖ Lejon detektimin në kohë të defekteve të brendshme, si rritje temperature, shkarkime elektrike ose degradim i izolimit.
- ❖ Është mjeti më i besueshëm për diagnostikim parandalues, për të shmangur dëmtime të rënda ose dështime katastrofike të transformatorëve të fuqisë.
- ❖ Bën të mundur planifikimin e mirë të mirëmbajtjes, në vend të ndërhyrjeve emergjente me kosto të lartë.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 39 prej 44
		Versioni	1.0

- ❖ Përdoret si standard ndërkombëtar për menaxhimin e gjendjes së transformatorëve
- ❖ Siguron besueshmëri më të lartë të furnizimit me energji dhe rrit jetëgjatësinë e transformatorëve.
- ❖ Redukton ndjeshëm rrezikun për ndërprerje në linjat kyçe dhe zvogëlon kostot për zëvendësime të parakohshme të transformatorëve.

Pajisja e Testimit të Reaktancës së Transformatorit: Përdoret për të testuar reaktancën e transformatorit, një parametër kritik që ndihmon në verifikimin e gjendjes së spiraleve dhe lidhjeve të brendshme.


- ❖ Detekton defekte të fshehura në izolime të dëmtuara apo lidhje të lirshme, që nuk mund të vërehen përmes testimeve të zakonshme.
- ❖ Përdoret gjatë testimeve pas instalimit, gjatë mirëmbajtjes periodike, dhe pas avarive për të verifikuar integritetin e transformatorit.
- ❖ Është metodë standarde për krahasim të performancës së transformatorit me të dhënat e fabrikës, për të detektuar devijime.
- ❖ Rrit sigurinë teknike dhe siguron që transformatorët në operim janë brenda parametrave të lejuar.
- ❖ Pajisje e domosdoshme për ekipet e testimit dhe mirëmbajtjes, për të garantuar sigurinë e rrjetit dhe transformatorëve të investuar.

Sistemi Informatik Gjeografik (GIS): Pilot projekti, i cili u përfundua me sukses pas mbledhjes së të dhënave nga punëtorët e KEDS-it u paraqit për shqyrtim dhe konfirmim nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë (ZRRE). Pas marrjes së konfirmimit dhe miratimit nga ky organ, DSO ka vazhduar me përgatitjen e nevojshme për të nisur fazat e mëtejshme të projektit.

Gjatë kësaj periudhe, DSO ka qenë aktivisht i angazhuar në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Kjo përfshin të gjitha specifikimet teknike, përshkrimin e projektit dhe çështje të tjera të lidhura me realizimin e projektit. Për më tepër, kompania ka përfunduar punën për të përcaktuar kërkesat dhe objektivat e projektit, të cilat janë thelbësore për implementimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave në terren. Derimë tani, janë alokuar burimet e nevojshme njerëzore për projektin dhe po formohen grupet e brendshme të projektit për integrimin e sistemit sapo të zgjidhet kontraktori. Nga ana tjetër, një investim tjetër ka qenë blerja e pajisjeve thelbësore, përfshirë pajisje për lokalizimin dhe detektimin e kabllave dhe një dron. Disa nga aktivitetet kryesore të cilat do të zhvillohen gjatë vitit 2026 janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 25. Aktivitetet brenda projektit të GIS


Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi i përgjithshëm
1	Verifikimi i infrastrukturës teknike	Sigurimi që infrastruktura përmbush kërkesat teknike
2	Mbledhja e të dhënave ekzistuese	Grumbullimi i të dhënave të TM/TU nga burime të ndryshme digjitale (Google Earth, AutoCAD, XLS, PDF, JPEG).
3	Mbledhja e të dhënave nga terreni	Përdorimi i tabletave me GPS për mbledhje të asetëve dhe elementeve në terren.
4	Regjistrimi i lidhjeve elektrike	Krijimi i lidhjeve teknike ndërmjet shtyllave, paneleve dhe pikave të konsumatorëve.
5	Përditësimi i skemave SLD	Rishikimi dhe korrigjimi i skemave teknike bazuar në gjetjet nga terreni.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 40 prej 44
		Versioni	1.0

6	Detektimi i rrjeteve nëntokësore	Përdorimi i pajisjeve për detektim dhe regjistrim të traseve nëntokësore dhe pusetave.
7	Verifikimi i KKSH dhe njehësorëve	Mbledhja dhe krahasimi i numrave të njehësorëve dhe KKSH me të dhënat e KEDS.
8	Vendosja e pllakëzave identifikuese	Montimi i pllakëzave me numra identifikues në të gjitha asetet dhe regjistrimi i tyre në GIS sipas standardeve.
9	Dokumentimi fotografik	Fotografimi i aseteve kryesore dhe organizimi me emërtime të standardizuara.
10	Verifikimi i gjendjes së ndërprerësve	Regjistrimi i statusit të ndërprerësve në rrjet dhe përputhja me SLD për të menaxhuar rrjedhën operative dhe normale të rrymës elektrike.
11	Pozicionimi GPS i saktë	Vendosja e saktë gjeohapësinore e aseteve sipas të dhënave të GPS.
12	Krijimi i lidhjeve gjeografike	Krijimi i rrjetit të plotë të lidhjeve elektrike në GIS për TM dhe TU.
13	Konsolidimi i të dhënave në zyrë	Përpunimi dhe integrimi i të dhënave të terrenit në modelin GIS të KEDS.
14	Raportimi i anomalive	Njoftimi i KEDS për mundësinë e mospërputhjeve, mungesa të dhënash apo probleme cilësie.
15	QA/QC dhe validiteti	Kryerja e kontrolleve të cilësisë, topologjisë dhe analizave të rrjetit.
16	Organizimi i ekipeve	Organizimi i ekipeve në zonat e caktuara
17	Integriteti i daljes (feeder)	Koordinimi i punës sipas strukturës së rrjedhës së energjisë për efikasitet.

Disa nga përparësitë kryesore të realizimit të sistemit GIS në Kosovë janë:

- ✓ Vizualizim i saktë i rrjetit në kohë reale: GIS mundëson një hartë digjitale ku të gjitha elementet e rrjetit (kabllot, trafot, shtyllat, etj.) janë të pozicionuara me koordinata gjeografike të sakta.
- ✓ Menaxhim më efikas i aseteve: Të gjitha asetet e rrjetit (trafot, linjat, lidhjet, konsumatorët) mund të ruhen, përditësohen dhe menaxhohen në mënyrë të centralizuar dhe të integruar.
- ✓ Reagim më i shpejtë ndaj defekteve dhe avarive: Në rast defekti, GIS ndihmon në lokalizimin e saktë të problemit, duke e reduktuar kohën e reagimit dhe riparimit.
- ✓ Planifikim dhe analizë më e mirë e rrjetit: GIS ofron mundësi për të analizuar kapacitetet ekzistuese, ngarkesat dhe nevojat për zgjerim apo modernizim të rrjetit.
- ✓ Integrim me sisteme të tjera (SCADA, AMI, DMS): GIS mund të lidhet me sisteme të avancuara të automatizimit për të krijuar një rrjet të mençur (smart grid) dhe për të ndihmuar në izolimin automatik të defekteve.
- ✓ Përmirësim i shërbimit ndaj konsumatorit: Lejon lokalizimin e saktë të konsumatorëve dhe rrugën më të shkurtër për ekipet e mirëmbajtjes, si dhe ndihmon në menaxhimin e kërkesave për lidhje të reja.
- ✓ Reduktim i humbjeve teknike dhe jo-teknike: Përmes analizës së rrjetit dhe konsumit, GIS ndihmon në identifikimin e humbjeve dhe ndërhyrjeve ilegale.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 41 prej 44
		Versioni	1.0

- ✓ Vendimmarrje më e informuar dhe strategjike: Menaxhmenti mund të marrë vendime bazuar në të dhëna vizuale dhe analitike për investime, mirëmbajtje dhe zgjerim të rrjetit.
- ✓ Përgatitje dhe menaxhim më i mirë për situata emergjente: GIS ndihmon në përgatitjen e skenarëve për ndërprerje të mëdha dhe koordinimin e veprimeve në rast fatkeqësish natyrore apo emergjencash.
- ✓ Dokumentim i përhershëm dhe i strukturuar i rrjetit: Të gjitha të dhënat historike dhe teknike për rrjetin ruhen në një bazë të dhënash të sigurt, që ndihmon në koordinim dhe planifikim afatgjatë

5.PROJEKTET NË NJEHSORË

Ne tabelën e mëposhtme janë dhënë projektet në njehsorë gjatë vitit 2026 dhe sasia e planifikuar për investim për njehsorë të mençur, indirekt, gjysmë indirekt dhe njehsorë elektronik të thjeshtë.

Tabela 26. Llojet e njehsorëve

Përshkrimi	Sasia (cope)
Njehsor të mençur	9,000
Njehsor indirekt	50
Njehsor gjysmë indirekt	500
Njehsor elektronik i thjeshtë	148,729
Upgrade i pajisjeve testuese lab	1
Sherbimi per ndrim njehsoreve	100,000
Totali	158,280

Tabela 27. Materialet e nevojshme për Mitrovicën e Veriut


Përshkrimi	Njësia	Sasia
Ormana	copë	5000
Kablo	m	100,000
Fidos	copë	30000
Gypa te brinjëzuar Ø32	m	25,000
Përforcues të gypave dhe kablllove	m	10000
Te tjera për Departamentin e Humbjeve	-	-
Total	-	170,000

6.PROJEKTET NË LOGJISTIKË

Në tabelën vijuese janë listuar projektet ne Logjistike për vitin 2026.

Tabela 28. Të dhënat e Logjistikës

Përshkrimi	Sasia
Automjete për operacione në terren	32
Automjete speciale për operacione në terren	18
Totali	50

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 42 prej 44
		Versioni	1.0

7.PROJEKTET E TEKNOLOGJISE INFORMATIVE(IT)

Projektet e IT-së bëjnë pjesë në projektet me një rëndësi dhe ndjeshmëri të veçantë pasi që i gjithë sistemi i KEDS mund të avancoj apo edhe të rrezikohet për shkak të mos harmonizimit dhe realizimit të investimeve të nevojshme qoftë në infrastrukturë të teknologjisë informative, asaj softuerike por edhe harduerike dhe duke mos e anashkaluar edhe sigurinë kibernetike. Në rastin kur sistemi informativ rrezikohet, atëherë në mënyrë direkte rrezikohen edhe operimet e KEDS. Në tabelën vijuese janë listuar projektet e Teknologjisë Informative për vitin 2026.

Tabela 29. Të dhënat për projektet e IT

Përshkrimi
ERP
Hardueri
Softueri
Siguria Kibernetike
Data Qendra
Licencë dhe implementim ERP/HR
ISU Project


SAP IS-U (Indstry Solution for Utilities)

Pas liberalizimit të tregut të energjisë elektrike janë krijuar kërkesa të reja rregullatore, operacionale si dhe kërkesa për mbështetje të konsumatorëve, të cilat sistemi ynë aktual (i trashëguar) nuk arrin t'i përmbushë. Me rritjen e pritur të bazës së konsumatorëve dhe rritjes së kompleksitetit të operimit të tregut të energjisë siç është ndërrimi i furnizuesve, matja transparente e konsumit, faturimi dhe mirëmbajtja e furnizuesve aktiv dhe potencial, një zgjidhje e dëshmuar në industrinë e shërbimeve publike si SAP IS-U (Indstry Solution for Utilities) është e domosdoshme.

SAP IS-U është një zgjidhje e zhvilluar posaçërisht nga SAP për kompanitë që operojnë në sektorin e energjisë dhe shërbimeve publike. IS-U ndihmon kompanitë që ofrojnë shërbime të energjisë elektrike, ujit, gazit dhe ngrohjes në menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të tyre. Ky modul integron dhe optimizon të gjitha proceset që lidhen me konsumatorët, matjen, faturimin, pagesat dhe shpërndarjen. IS-U rrit efikasitetin operacional të kompanive duke ndihmuar në menaxhimin e të gjitha proceseve që janë kritike për sektorin e energjisë.


SAP IS-U ofron:

- **Zgjidhje të integruara:** Siguron operim më efikas dhe më të koordinuar përmes integritetit të të gjitha proceseve të biznesit. Lejon kryerjen e operacioneve të shumta të biznesit në një mjedis të centralizuar dhe me një burim të vetëm të së vërtetës (single point of truth).
- **Menaxhim të të dhënave të mëdha- Big Data:** Mundëson menaxhimin e saktë dhe të sigurt të të dhënave të mëdha dhe komplekse. Ofron infrastrukturë që mund të përshtatet lehtësisht me rritjen e numrit të konsumatorëve si dhe redukton humbjet e të ardhurave.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 43 prej 44
		Versioni	1.0

- **Përputhshmëri me rregullatorin:** Mund të përshtatet me kornizën ligjore të aplikueshme për sektorin si dhe ofron zgjidhje që janë në përputhje të plotë me standardet e industrisë.
- **Rritje të efikasitetit:** Përshpejton vëllimin e punës duke eliminuar proceset manuale dhe duke ofruar mjete dhe fleksibilitet për t'iu përgjigjur lehtësisht ndryshimeve në treg, për të optimizimuar operimin, dhe për të parandaluar dështimin e sistemit.

Përmirësim të shërbimit të konsumatorëve: Ofron kanale moderne të komunikimit me konsumatorë duke përmirësuar eksperiencën e tyre dhe duke i ofruar kompanisë vizibilitet të plotë dhe të integruar në të dhënat e secilit konsumator.

	NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM	Nr.	KEDS-DIV-O-DPP-03
	PLANI INVESTIV NJË VJEÇAR I OSSH-së	Faqe	Faqe 44 prej 44
		Versioni	1.0

8.PËRFUNDIM

Siç është theksuar në pjesët e mëparshme, është shumë e rëndësishme të zhvillohet vazhdimisht rrjeti i shpërndarjes, veçanërisht në Kosovë, i cili ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Këto investime janë të nevojshme për OSSh-në për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe cilësore. Nevoja për rehabilitimin, zgjerimin, adaptimin dhe aplikimin e standardeve në asetet e sistemit të shpërndarjes është shumë e qartë. Për shkak të kushteve në terren që janë evidente dhe në përputhje me objektivat e rrjetit, nevoja për të orientuar investimet në nivelin e tensionit të ulët si projekte me prioritet të lartë, është e qartë; veçanërisht në fushën më problematike në të cilën ka nevojë për një zgjidhje emergjente dhe që ndikon në një numër më të madh të konsumatorëve. Përmirësimi i kapaciteteve të kufizuara në sistemet e mbingarkuara me tension të lartë dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e rrjetit të tensionit të ulët konsiderohet si kriter bazë meqë plotëson kushtet teknike dhe ekonomike për planifikimin e rrjetit të shpërndarjes dhe siguron furnizim cilësor dhe të sigurtë për pjesën më të madhe të konsumatorëve. Si të tilla, këto projekte përfshihen në Planin Investiv 2024.

Projektet janë të fokusuar në rritjen e besueshmërisë duke zvogëluar ndërprerjet e energjisë elektrike për shkak të ngarkesës (duke përmirësuar SAIDI-n dhe SAIFI-n) në saje të plotësimit të kriterit N-1 dhe duke zvogëluar ngarkesat në daljet e mbingarkuara. Dizajni i ri i projekteve do të sigurojë që kualiteti i përgjithshëm i tensionit të përmirësohet gjithashtu. Përmirësimet në kualitetin e tensionit dhe zvogëlimin e ngarkesave në daljet e mbingarkuara, do të rezultojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike.

Është e rëndësishme të theksohet se disa nga përfitimet e OSSh-së janë të pamatshme, por megjithatë ato ndikojnë në të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike, duke përmirësuar shërbimet e shpërndarjes, rritjen e efikasitetit të fuqisë punëtore dhe cilësinë e furnizimit. Për më tepër, siç u tha më parë, disa nga projektet e parashikuara janë gjithashtu për shkak të kërkesave ligjore, siç janë zëvendësimet e njehsorëve, apo deri tek kërkesat e reja që rrjedhin nga ndryshimet në legjislacion (hapja e tregut). Zbatimi i këtyre projekteve do të mundësojë zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit, do të krijojë kushte të favorshme për konsum të sigurtë, cilësor dhe efikas të energjisë elektrike.